



REPUBLIKA E SHqipërisë

**BASHKIA PATOS**  
**KRYETARI**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më 20/02/2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje GPS për nevoja të drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të territorit”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
Pajisje topografie 38295000-9**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 1,747,000 (një milion e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë) lekë pa TVSH, venë në dispozicion nga të ardhurat lokale 2024.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve.

### **2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

$$1,747,000 \times 40\% = 698,800$$

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.*

**2.2.2** Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

*Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e*

*aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

$$1,747,000 \times 20\% = 349,400$$

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci 1 (një) vjeçare për produktet e ofertuara nga momenti i marrjes në dorëzim, si dhe ndërrimin në raste defektsh nëpërmjet një deklarate për periudhën e garancisë, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë edhe riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale, jetëgjatësi dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

Nisur nga rëndësia që ka objekti prokurimit për mbarëvajtjen e punës në institucion kërkohet ky kriter për të ofruar siguri autoritetit kontraktor.

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëpërmjet paraqitjes së një deklarate se merr përsipër të realizojë furnizimin e mallrave objekt prokurimi (përfshirë kryerjen e shërbimit të transportit të të gjithë artikujve në ambientet e Autoritetit Kontraktor, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambientet e magazinës pranë Bashkisë Patos në datën 04/03/2024 deri në orën 09:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Njësia	Sasia
1	Pajisje GPS	SET	1
2	GPS SET DRONE me stacionin bazë	SET	1

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

**Shënim:** Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat e dorëzuara do të kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Duke qenë se pajisjet janë specifike dhe përdorimi i tyre është shumë profesional është e nevojshme sjellja e mostrave për të vërtetuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e pajisjeve me procesin e punës.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 gërma a, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesi Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mëposhtëme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën shqipe.

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Njësia	Sasia
1	Pajisje GPS	SET	1
2	GPS SET DRONE me stacionin bazë	SET	1
3	Matës profesional rrugor me rrotë	Copë	1

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 6 b të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky kriter kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të deklaroj se do të ofroj trajnim 2 ditor për përdorimin e pajisjeve objekt prokurimi sipas nevojës së autoriteti kontraktor.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

*Shënim:* Duke qënë se këto pajisje janë specifike, profesionale dhe është hera e parë që blihen pajisje të tilla në këtë institucion është e nevojshme kryerja e një trajnimit nga persona të specializuar për përdorimin e këtyre pajisjeve.

## Specifikimet për pajisjen GPS

Sinjalet satelitore që gjurmohen njëkohësisht	GPS: 11 C/A, L2C, L2P, L5
	GLONASS: L1C/A, L1P, L2 C/A, L2P
	BEIDOU: B1, B2, B3, B1C, B2a, B2b
	GALILEO: E1, E5a, E5b, AltBOC
	QZSS: L1, L2C, L5
	SBAS: WAAS, EGNOS, MSAS GAGAN, SDCM
	IRNSS:L5
	L-band

Kanalet	$\geq 1408$ kanalet e gjurmimit
Fillimi i ftohtë	$< 60s$
Fillimi i nxehtë	15 s
Shkalla e pozicionimit të prodhimit	1Hz – 20Hz
Marrja e sinjalit	$< 1s$
Koha e inicimit të RTK-së	$< 10s$
Besueshmëria e inicializimit	$> 99.99\%$
Saktësia e kohës	20ns

## Pozicionimi

Pozicionimi diferencial i kodit GNSS	Horizontal: 0.25m + 0.5ppm RMS
	Vertikal: 0.5 m + 1 ppm RMS
	Saktësia e pozicionimit diferencial SBAS zakonisht $< 5$ m 3DRMS
Studim statik GNSS	Horizontal: 3mm + 01ppm RMS
	Vertikal: 3.5 mm + 0.4 ppm RMS
Statike e shpejte	Horizontal: 2.5mm + 0.5 ppm Vertikal: 5 mm + 0.5ppm
E-RTK ( $< 100km$ ) <sup>1</sup>	Horizontal: 0.2mm + 1 ppm Vertikal: 0.4 mm + 1 ppm
DGPS	$< 0.4m$ RMS
SBAS	1M 3D RMS
E vetme	1.5m 3D RMS

### Anketa Kinematike në kohë reale

Baza e vetme $< 30$ KM	Horizontal: 8mm + 1ppmm RMS Vertikal: 15mm + 1ppm RMS
Rrjeti RTK	Horizontal: 8mm + 0.5ppmm RMS

	Vertikal: 15mm + 0.5ppm RMS
--	-----------------------------

## Pajisje fizike

Fizike	
Materiali	Aliazh magnezi
Dimensionet	≤150mm * ≤71mm (pa lidhës në fund ≤60 mm)
Pesha	≤1.0 Kg
Temperatura e funksionimit	-40 <sup>0</sup> C to + 75 <sup>0</sup> C
Temperatura e ruajtjes	-55 <sup>0</sup> C to + 85 <sup>0</sup> C
IP mbrojtëse	I papërshkueshëm nga pluhuri IP67, i mbrojtur nga zhytja në ujë 30 minuta në thellësi 1 m
Shoku	Mbijeton një rënie prej 2 metrash mbi beton
Dridhja	MIL-STD-810G
Lagështia	100% kondensim

## Elektrike

Fuqia: Hyrja e jashtme e rrymës 5-27 V DC në pinin e portës USB/Lemo	
Karikim i shpejtë USB Type-C	
Bateria e brendshme litium-jon ≥6800Ma	
Jetëgjatësia e baterisë	Modaliteti Rover: ≥12 orë
	Modaliteti bazë: ≥7 orë
	Modaliteti statik: ≥15 orë

## Komunikimi dhe ruajtja e të dhënave

I/O ndërfaqe	
Port LEMO (5pin)	Mbështet hyrjen e energjisë, kontrollin e portës serike dhe komunikimin me radio të jashtme
Porta USB Type-C	Shkarkimi/karikimi i të dhënave
Vendi i kartës SIM	Mbështet Nano – SIM
Porta e antenës	Ndërfaqja e antenës UHF

## ModemI radio

Transmetoni fuqinë	½ w i ndërrueshëm, diapazoni i punës mund të arrijë në 15 km sipas protokollit Alpha Talk15
Brezi i frekuencës	410MHz-470MHz; mbështet për të vendosur frekuencën



Protokollet	Aplha Talk15, TrimTalk450s, SOUTH, Satel, PCC-EOT
-------------	---

## Qeliza

Modem 4G i integruar me shumë breza me frekuencë të plotë, mbështet, WCDMA/CMA2000/TDD-LTE/FDD-LTE
--

## WIFI

802.11 B/G standardi, pika e hyrjes dhe modaliteti i klientit, mbështet aksesin në pikën e nxehtë për transmetimin e korigjimit
---

## Bluetooth

Bluetooth V4.0 i integruar plotësisht, rreze $\leq 50$ m
--

## Formati i të dhënave

RTCM2x, rctm3x, CMR & CMR+, sCMRx
Dat, RINES, NMEA outputs

## Memorie

8 GB memorie të brendshme, mbështet ruajtjen ciklike; me aftësinë për të mbledhur mbi një vit vëzhgim të papërpunuar bazuar në një interval prej 5 sekondash
--

## Të tjerët

Integrimi i sistemit	
Sistemi OS:	Sistemi operativ inteligjent LINUX/Android
Kompensimi i animit	IMU deri në 60° (pa kalibrim)
Stacioni stafetë	CORS me të vërtetë, radio stafetë
Kontrollorët e mbështetur	Të gjitha pajisjet Android me softuer të mbështetur

Dizajni	
Butoni	Tasti i energjisë
Treguesi	Treguesi i energjisë, treguesi i lidhjes së të dhënave, treguesi i satelitit, treguesi Bluetooth
Zëri	Kërkesa inteligjente me zë
WEBUI	Mbështet konfigurimin WEBUI

**Pajisje GPS duhet të jetë e pajisur me të gjitha pajisjet trasmetuese, këmbët mbajtëse për pajisjet e trasmetimit valixhen ose valixhet përkatëse.**

**Seti duhet të jetë i pajisur me katalog, manual përdorimi dhe skedën teknike**

**Specifikimet teknike për ‘DRONE’ GPS SET me stacionin bazë**

**Specifikimet për fluturuesin**

- Pesha (me helikë, pa aksesore) 910 gr deri në 920 gr
- Pesha maksimale e ngritjes  $\geq 1,050$ gr
- Dimensionet: E palosur (pa helikë):  $\leq 221 \times \leq 96,3 \times \leq 90,3$  mm (L×W×H), E shpalosur (pa helikë):  $\leq 347,5 \times \leq 283 \times \leq 107,7$  mm (L×W×H)
- Distanca diagonale:  $\geq 380.1$  mm
- Shpejtësia maksimale e ngjitjes:  $\geq 6$  m/s (Modaliteti Normal),  $\geq 8$  m/s (Modaliteti sportiv)
- Shpejtësia maksimale e zbritjes:  $\geq 6$  m/s (Modaliteti normal),  $\geq 6$  m/s (Modaliteti sportiv)
- Shpejtësia maksimale e fluturimit (në nivelin e detit, pa erë):  $\geq 15$  m/s (Modaliteti normal), Përpara:  $\geq 21$  m/s, anësore:  $\geq 20$  m/s, prapa:  $\geq 19$  m/s (Modaliteti sportiv)
- Rezistenca maksimale e shpejtësisë së erës:  $\geq 12$  m/s
- Lartësia maksimale e ngritjes mbi nivelin e detit: 6000 m (pa ngarkesë)
- Koha maksimale e fluturimit (pa erë): 45 minuta
- Koha maksimale e qëndrimit pezull (pa erë): 38 minuta
- Distanca maksimale e fluturimit: 32 km
- Këndi maksimal i lartësisë:  $30^\circ$  (Modaliteti normal),  $35^\circ$  (Modaliteti sportiv)
- Shpejtësia maksimale këndore:  $200^\circ/s$

(a) GNSS

GPS+Galileo+BeiDou+GLONASS (GLONASS mbështetet vetëm kur moduli RTK është i aktivizuar)

- Saktësia e qëndrimit pezull: Vertikale:  $\pm 0.1$  m (me Vision System);  $\pm 0.5$  m (me GNSS);  $\pm 0.1$  m (me RTK), Horizontal:  $\pm 0.3$  m (me Vision System);  $\pm 0.5$  m (me sistem pozicionimi me precizion të lartë);  $\pm 0.1$  m (me RTK)
- Gama e temperaturës së funksionimit,  $-10^\circ$  to  $40^\circ$  C ( $14^\circ$  to  $104^\circ$  F)
- Memoria e brendshme: E padisponueshme

(a) Modeli Helikave

Helika për përdorim profesional

- Fener (ndricues): E ndërtuar në DRONE

## Kamera e gjerë

- Sensori: 4/3 CMOS, Piksele efektive: 20 MP, CMOS 1/2 inç, Piksele efektive: 48 MP

Lente:

FOV: 84°

Ekuivalenti i formatit: 24 mm

Apertura: f/2.8-f/11

Fokusimi: 1 m në ∞

ose

FOV: 84°

Ekuivalenti i formatit: 24 mm

Apertura: f/2.8

Fokusimi: 1 m në ∞

Diapazoni ISO: **100-6400, 100-25600**

- Shpejtësia e mbylljes: Mbyllesi Elektronike: 8-1/8000 s, Mbyllesi Mekanike: 8-1/2000 s
- Madhësia maksimale e imazhit: 5280×3956, 8000×6000
- Mënyrat e fotografimit: E vetme: 20 MP, Koha: 20 MP, JPEG: 0.7/1/2/3/5/7/10/15/20/30/60 s, JPEG+RAW: 3/5/7/10/15/20/30/60 s, Regjistrimi inteligjent në dritë të ulët: 20 MP, Panorama: 20 MP (imazh i papërpunuar) ose E vetme: 12 MP/48 MP, Koha: 12 MP/48 MP, JPEG: 2/3/5/7/10/15/20/30/60 s\*, Panorama: 12 MP (imazh i papërpunuar); 100 MP (imazh i qepur), Regjistrimi i fotografisë 48 MP nuk mbështet intervalin 2 sekonda, Regjistrimi inteligjent në dritë të ulët: 12 MP
- Rezolucioni i videos: H.264, 4K: 3840×2160@30fps, FHD: 1920×1080@30fps
- Shpejtësia e biteve: 4K: 130 Mbps, FHD: 70 Mbps, 4K: 85 Mbps, FHD: 30 Mbps
- Formatet e skedarëve të mbështetur: exFAT
- Formatet e fotografisë: JPEG/DNG (RAW), JPEG
- Formatet e videos: MP4 (MPEG-4 AVC/H.264)

## Telekamera

- Sensor: 1/2-inch CMOS, Piksele efektive: 12 MP
- Lente: FOV: 15°, Ekuivalenti i formatit: 162 mm, Apertura: f/4.4, Fokusimi: 3 m në ∞
- Diapazoni ISO : 100-6400, 100-25600
- Shpejtësia e mbylljes: Mbyllja Elektronike: 8-1/8000 s
- Madhësia maksimale e imazhit: 4000×3000
- Formatet e fotografisë: JPEG

- Formati i videos: MP4 (MPEG-4 AVC/H.264)
- Mënyrat e fotografimit: E vetme: 12 MP, Me diapazon kohor: 12 MP, JPEG: 0.7/1/2/3/5/7/10/15/20/30/60 s, Regjistrimi inteligjent në dritë të ulët: 12 MP ose E vetme: 12 MP, Me diapazon hokor: 12 MP, JPEG: 2/3/5/7/10/15/20/30/60 s, Regjistrimi inteligjent në dritë të ulët: 12 MP
- Rezolucioni i videos: H.264, 4K: 3840×2160@30fps, FHD: 1920×1080@30fps
- Shpejtësia e biteve: 4K: 130 Mbps, FHD: 70 Mbps ose 4K: 85 Mbps, FHD: 30 Mbps
- Zmadhimi dixhital: 8x (56x zmadhimi hibrid)

## **Gimbal**

- Stabilizimi: 3-boshte (anim, rrotull, pan)
- Gama mekanike: Pjerrësia: -135° deri në 100°, Roll: -45° deri në 45°, Pan: -27° deri në 27°
- Gama e kontrollueshme: Pjerrësia: -90° deri në 35°, Pan: Jo i kontrollueshëm
- Shpejtësia maksimale e kontrollit (anim):  $\geq 100^\circ/s$
- Gama e dridhjeve këndore:  $\pm 0.007^\circ$

## **Ndjeshmëria**

- Lloji: Sistemi i shikimit binocular omnidirectional, i plotësuar me një sensor infra të kuqe në fund të avionit.
- Përpara: Gama e matjes: 0,5-20 m, Gama e zbulimit: 0,5-200 m, Shpejtësia efektive e sensorit: Shpejtësia e fluturimit  $\leq 15$  m/s, FOV: Horizontal 90°, Vertikal 103°
- Pas: Gama e matjes: 0,5-16 m, Shpejtësia efektive e sensorit: Shpejtësia e fluturimit  $\leq 12$  m/s, FOV: Horizontale 90°, Vertikale 103°
- Anësor: Gama e matjes: 0,5-25 m, Shpejtësia efektive e sensorit: Shpejtësia e fluturimit  $\leq 15$  m/s, FOV: Horizontale 90°, Vertikale 85°
- Lart: Gama e matjes: 0,2-10 m, Shpejtësia efektive e sensorit: Shpejtësia e fluturimit  $\leq 6$  m/s, FOV: Përpara dhe mbrapa 100°, majtas dhe djathtas 90°
- Poshtë: Gama e matjes: 0,3-18 m, Shpejtësia efektive e sensorit: Shpejtësia e fluturimit  $\leq 6$  m/s, FOV: Përpara dhe mbrapa 130°, majtas dhe djathtas 160°
- Mjedisi operativ: Përpara, prapa, anësore dhe lart: sipërfaqe me një model të qartë dhe ndriçim të mjaftueshëm (lux >15), nga poshtë: Sipërfaqe reflektuese difuze me reflektim difuz >20% (p.sh. mure, pemë, njerëz) dhe ndriçim adekuat (lux >15)

## **Transmetimi i videos**

- Sistemi i Transmetimit të Videos: Trasmetim profesional
- Cilësia e pamjes së drejtpërdrejtë: Telekomanda: 1080p/30fps
- Frekuenca e funksionimit: 2.400-2.4835 GHz, 5,725-5,850 GHz

- Distanca maksimale e transmetimit (pa pengesa, pa ndërhyrje): FCC:  $\geq 15$  km, CE:  $\geq 8$  km, SRRC:  $\geq 8$  km, MIC:  $\geq 8$  km
- Distanca maksimale e transmetimit (e penguar)  
Ndërhyrje të forta (ndërtesa të dendura, zona banimi, etj.): 1,5-3 km (FCC/CE/SRRC/MIC)  
Ndërhyrje mesatare (zonat periferike, parqet e qytetit, etj.): 3-9 km (FCC), 3-6 km (CE/SRRC/MIC)  
Ndërhyrje e ulët (hapësira të hapura, zona të largëta, etj.): 9-15 km (FCC), 6-8 km (CE/SRRC/MIC)
- Shpejtësia maksimale e shkarkimit:  $\geq 15$  MB/s
- Vonesa (në varësi të kushteve mjedisore dhe pajisjes celulare): Përafërsisht. 200 ms
- Antenë:  $\geq 4$  Antena, 2T4R
- Fuqia e Transmisionit (EIRP): 2.4 GHz:  $< 33$  dBm (FCC),  $< 20$  dBm (CE/SRRC/MIC), 5.8 GHz:  $< 33$  dBm (FCC),  $< 30$  dBm (SRRC),  $< 14$  dBm (CE)

## Specifikimet teknike të telekomandës

- Sistemi i Transmetimit të Videos: Transmetim profesional
- Distanca maksimale e transmetimit (pa pengesa, pa ndërhyrje): FCC: 15 km, CE/SRRC/MIC: 8 km
- Frekuenca e funksionimit të transmetimit të videos: 2.400-2.4835 GHz, 5.725-5.850 GHz
- Antenë:  $\geq 4$  Antennas, 2T4R
- Fuqia e transmetuesit të transmetimit video (EIRP): 2.4 GHz:  $< 33$  dBm (FCC),  $< 20$  dBm (CE/SRRC/MIC), 5.8 GHz:  $< 33$  dBm (FCC),  $< 14$  dBm (CE),  $< 23$  dBm (SRRC)
- Protokoll i Wi-Fi: 802.11 a/b/g/n/ac/ax, Mbështetja 2x2 MIMO Wi-Fi
- Frekuenca e funksionimit të Wi-Fi: 2.400-2.4835 GHz, 5.150-5.250 GHz, 5.725-5.850 GHz
- Fuqia e transmetuesit Wi-Fi (EIRP): 2.4 GHz:  $< 26$  dBm (FCC),  $< 20$  dBm (CE/SRRC/MIC), 5.1 GHz:  $< 26$  dBm (FCC),  $< 23$  dBm (CE/SRRC/MIC), 5.8 GHz:  $< 26$  dBm (FCC/SRRC),  $< 14$  dBm (CE)
- Protokoll i Bluetooth: Bluetooth 5.1
- Frekuenca e funksionimit Bluetooth: 2.400-2.4835 GHz
- Fuqia e transmetuesit Bluetooth (EIRP):  $< 10$  dBm
- Rezolucioni i ekranit: 1920x1080
- Madhësia e ekranit: 5.5 inches
- Ekran: 60 fps
- Shkëlqimi:  $\geq 1,000$  nits
- Kontrolli i ekranit me prekje: Me shumë prekje me 10 pika
- Bateri: Li-ion ( $\geq 5000$  mAh @ 7.2 V)
- Lloji i karikimit: Rekomandohet karikuesi me përshtatësin e energjisë USB-C të përfshirë (100W) ose karikues USB në 12 V ose 15 V

- Fuqi e vlerësuar: 12 W
- Kapaciteti ruajtës i memories: Hapësira e brendshme (ROM): 64 GB, Mbështet një kartë microSD për kapacitet të zgjeruar.
- Koha e karikimit  
Përafërsisht. 1 orë 30 minuta (me përshtatësin e rrymës të përfshirë USB-C (100W) që karikon vetëm telekomandën ose një karikues USB në 15 V)  
Përafërsisht. 2 orë (me një karikues USB në 12 V)  
Përafërsisht. 2 orë 50 minuta (me përshtatësin e energjisë USB-C të përfshirë (100 W) duke karikuar njëkohësisht avionin dhe telekomandën)
- Koha e funksionimit: Përafërsisht 3 ore
- Porta e daljes video: Porta mini-HDMI
- Gama e temperaturës së funksionimit: -10° to 40° C (14° to 104° F)
- Temperatura e ruajtjes  
-30° --- 60° C (-22° to 140° F) (brenda një muaji)  
-30° --- 45° C (-22° to 113° F) (një deri në tre muaj)  
-30° --- 35° C (-22° to 95° F) (tre deri në gjashtë muaj)  
-30° --- 25° C (-22° to 77° F) (më shumë se gjashtë muaj)
- Temperatura e karikimit: 5° to 40° C (41° to 104° F)
  - (a) GNSS
- GPS+Galileo+GLONASS

## Memoria

- **Mbështetja me kartë memorie**  
Kërkohet U3/Class10/V30 ose më lart. Një listë e kartave microSD të rekomanduara mund të gjendet më poshtë.
- Kartat microSD të rekomanduara  
Dirigjuesi:  
SanDisk Extreme PRO 64GB V30 A2 microSDXC  
SanDisk High Endurance 64GB V30 microSDXC  
SanDisk Extreme 128GB V30 A2 microSDXC  
SanDisk Extreme 256GB V30 A2 microSDXC  
SanDisk Extreme 512GB V30 A2 microSDXC  
Lexar 667x 64GB V30 A2 microSDXC  
Lexar High-Endurance 64GB V30 microSDXC  
Lexar High-Endurance 128GB V30 microSDXC  
Lexar 667x 256GB V30 A2 microSDXC  
Lexar 512GB V30 A2 microSDXC  
Samsung EVO Plus 64GB V30 microSDXC  
Samsung EVO Plus 128GB V30 microSDXC

Samsung EVO Plus 256GB V30 microSDXC  
Samsung EVO Plus 512GB V30 microSDXC  
Kingston Canvas Go! Plus 128GB V30 A2 microSDXC  
Kingston Canvas React Plus 128GB V90 A1 microSDXC  
Aircraft:  
SanDisk Extreme 32GB V30 A1 microSDHC  
SanDisk Extreme PRO 32GB V30 A1 microSDHC  
SanDisk Extreme 512GB V30 A2 microSDXC  
Lexar 1066x 64GB V30 A2 microSDXC  
Kingston Canvas Go! Plus 64GB V30 A2 microSDXC  
Kingston Canvas React Plus 64GB V90 A1 microSDXC  
Kingston Canvas Go! Plus 128GB V30 A2 microSDXC  
Kingston Canvas React Plus 128GB V90 A1 microSDXC  
Kingston Canvas React Plus 256GB V90 A2 microSDXC  
Samsung PRO Plus 256GB V30 A2 microSDXC

### **Bateria**

- Kapaciteti:  $\geq 5000$  mAh
- Tensioni standard: 15.4 V
- Tensioni maksimal i karikimit: 17.6 V
- Lloji: LiPo 4S
- Sistemi Kimik: LiCoO<sub>2</sub>
- Energjia: 77 Wh
- Temperatura e karikimit: 5° to 40° C (41° to 104° F)

### **Moduli RTK**

- Pesha: 24±2 g
- Interface: USB-C
- Fuqia: Përafërsisht. 1.2 W
- Saktësia e pozicionimit të RTK-së: Rregullimi i RTK-së: Horizontal: 1 cm + 1 ppm; Vertikal: 1.5 cm + 1 ppm

### **Fonia**

- Pesha: 85±2 g
- Interface: USB-C
- Fuqi e vlerësuar:  $\leq 3$  W
- Vëllimi maksimal: 110 dB @ 1 m
- Distanca efektive e transmetimit: 100 m @ 70 dB
- Shpejtësia e biteve: 16 Kbps/32 Kbps
- Gama e temperaturës së funksionimit: -10° to 40° C (14° to 104° F)

**Seti duhet të jetë i pajisur me të gjitha pajisjet trasmetuese, këmbët mbajtëse për pajisjet e trasmetimit valixhen ose valixhet përkatëse.**

**Seti duhet të jetë i pajisur me katalog, manual përdorimi dhe skedën teknike.**

## **Matës profesional rrugor me rrotë**

- Matës profesional rrugor me rrotë ABS.
- Rrota, e bërë nga ABS e fortë dhe e lehtë, duhet të ketë një perimetër 1 metër dhe është e pajisur me ndalues.
- Njehsues preciz, i forte dhe kompakt, i zëvendësueshem në rast thyerjeje.
- Butoni i rivendosjes së shpejtë.
- Matje dhe llogaritje nga 0 në 9999.99m.
- Lexim centimetri.
- Peshë totale  $\leq 2.7$  kg.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike janë hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë institucionit Bashkia Patos në përputhje me objektin e prokurimit dhe nevojat e autoritetit kontraktor, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilesise” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

### **Shënim:**

Referuar udhëzimeve të APP, për zërat në DST që mund të jete paraqitur marke/brand, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 04.03.2024, ora 09:00.

**NJËSIA E PROKURIMIT**